



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 11.06.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:

“KASHARI CENTER- OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIMI 1 DHE 9 KATE MBI TOKË
DHE 2 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN E KASHARIT,
BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “Kashari Center” sh.p.k. dhe Z. Behar Çukaj, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kashari Center- Objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 9 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bulevardin e Kasharit, Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues “Kashari Center” sh.p.k. dhe Z. Behar Çukaj.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDAROKA



Nënshkruar më datë 10/04/2026